

KUSH ÆSHT XENU?

Du mi jav kallxu nji prallë. Uluni...komfort? Mirë, ja nisim.

Dikur para shumë kohe (para 75 milion vjetëve) ka egzistuar nji general galaktik i qujtun Xenu (lexohet Xinu). Xenu i ka pasë nën kontrollë të gjitha planetat në këtë pjesë të galaksisë, përfshirë këtu edhe planetën tonë e cila u qujt n'atë kohë Teegeeeack (Tixhiak).

Xenu ka pasë probleme. Të gjitha 76 planetet nën kontrollin e tij, jon kanë t'stërpopullime. Çdo planetë ka pasë mbi 178 miliardë banorë. Ai deshti me zgjedh kit problem edhe e pat bo ni plan.

Xenu e vuni galaksinë nën kontrollë të plotë me ndihmën e t'arratisunve, arriten mi mposhte njerzt e mirë edhe Oficerët Lojal. Me ndihmën e psikiatrive, ai tani thirri me miliarda njerz për mi jav bo kontrollimin e taksav, po n'vend t'inspektionit ju dha inekcione t'perzime me alkool edhe glykol, për m'i paralizu. Pastaj i shtini t'gjith kta njerz ne anije fluturake, qi doken gati krejt si DC8-she (po veq me raketa).



Qito anije fluturake DC8-she fluturun drejt tokes, edhe krejt kta trupa t'paralizum, me miliarda njerz, jon palu neper vulkane. Kur i palun krejt trupat, i ulen edhe bombat hidrogjenike përmys. Xenu tani i detonoi këto bomba në t'njëjtën kohë, edhe të gjith kta njerz vdekën përneher.

Mirpo tregimi nuk përfundon aty. Masi qi krejt njerzt kanë shpirta (këtu thirr Mirpo tregimi nuk përfundon aty. Masi qi krejt njerzt kanë shpirta (këtu thirren "Theatan"-a: lexo: "thitan") jon duft diqysh mi mashtru qi mos m'u kthy ma. Kta shpirta mas bombardimit u sillshin neper erëna nukleare, e për me i nxonë, Xenu kish do kurtha speciale elektronike, edhe nëpërmjet tynve i burgoske nëpër valë elektronike (këto valë elektronike ishin shumë ngjitse, si shiriti për miza).

Masi qi ja arriti me i kap të gjith shpirtat, i pakoi nëpër kutia edhe i transportoi deri te nja dy kinemaja shume t'mdhaja. Nëpër qato kinemaja shpirtat kalojshin ditë tu kqyr filma special 3-dimensional, ku ju kallxojke se qysh jeta duhet mu kanë edhe shumë gjana tjera konfuze. Si p.sh. fotografia t'rrejtshme ku pershkruhen Zoti, Dreqi edhe Krishti. Ky fenomen u thirrke "implantim". Kur jon kry filmat, shpirtat ja nisën me lshu venin, edhe mu ngjit njoni me tjetrin sepse mendojshin qi jon bo nji, masi ton bashk e kqyrën t'njëjtin film. Ja nisën mu bashku nëpër grupe me ka 2000 veta. Tash, masi shume pak njerz mbetën gjallë n'toke mas kti masakri vullanik, qito grupime t'shpirtave fillun mi ju ngjit njerzve t'gjallë.

Xenun ma vonë e rrxun prej pushteti Oficerët Lojal edhe e burgosën me ni mal me ni planetë. Ai mahet me ni forcë-fushë qi fuqizohet prej një baterie të përjetshme, Xenu është hala gjallë sot e kësaj dite.


Edhe ky është fundi i tregimit. Edhe qashtu sot këto grupime t' shpirtave thirren Theatana trupëror (lexo: thitana). Edhe për me pasë shpirtin e lirë, atëherë na duhmi mi hjek krejt kësaj Theatana shpirtëror, e kjo kushon shumë për. Edhe e vetmja arsye pse njerzit sot besojnë në Zot e në Krisht është për shkak se qashtu u përshkrua në filmin që e kanë për Thetanat trupëror para 75 milion vjetëve.

Çka thu ti rreth kësaj pralle?

Qysh? Pollavër??

Qashtu edhe na mendojta, ky sen është budallaki. Po për fat të keq qikë tregim formon bazën e besimeve të Scientologëve. Me pasë ditë tregim që prej fillimit, shumica e njerzve kurrë nuk ishin përzi me këtë sektë. Këtë tregim ata ta kallxojnë kur ta mrrish nivelin OT III. Tani ka mu prit prej teje që ti me komunikim me kësaj Theatana trupëror edhe mi shti mu qkap prej teje (met lonë rahat). Ka me të kushtu shumë shtrejt me mri këtë nivel edhe mi "bo" këto sene (përndryshe duhesh me punu natë e ditë për këtë organizatë për për të vogla për kohë shumë të gjatë).

Na po jav tregojta këtë sen mi jav tërheq vërejtjen. Nëse lidhni me Scientologun, atëherë boneni me sy të hapun edhe gjithë mi pasë parasysh se cka përmbanë.



Pjesa e parë e dokumentit sekret OT III e shkruar prej vet L. Ron Hubbard

www.xenu.net

Shumica e Scientologëve të cillt punojnë në qendrat e tyre Dianetike edhe nëpër të ashtuqujtunat "Kisha" Scientologjike nuk e dinë këtë "incident" apo prallë edhe nuk lejohen me ditë deri sa s' t'i mrrinë këto nivele "të larta" të Scientologjisë. Kalojnë shumë vjetë para se me mri "nivele", t' shumtën e rasteve kjo nuk ndodhë kurrë. Ata që e dinë, jon t' detyruim me majt si msheftsi edhe mos mi jav kallxu fillestarve.

Tash masi e ki lexu kit sen e din msheftsinë mat madhe të tynve. Veç nëse bash don mi ju bashkangjit, atëherë na nuk t' nalim.

* Dianetika edhe Scientologjia janë marka të Qendrës për Teknologjinë Religjioze. Ky dokument nuk ka kurrëfar lidhje me atë organizatë në asnjë mënyrë.